
DOKUMENTE E MATERIALE

PRANVERA DIBRA TELI**MARRËDHËNIET DIPLOMATIKE E KONSULLORE
SHQIPËRI-AUSTRI, 1922-1992**

Në vazhden e rekordeve pozitive që ofron historia e marrëdhënieve midis popujve të dy vendeve, Shqipërisë dhe Austrisë, marrëdhëniet midis dy shteteve, që nga vendosja e tyre në vitin 1922 e në vazhdim, janë karakterizuar gjithmonë nga stabiliteti dhe vullneti për të nxitur bashkëpunimin dhe miqësinë reciproke në përputhje me rrethanat historike nëpër të cilat kaluan dy vendet.

Vendosja e marrëdhënieve diplomatike

Pas vendimit të Konferencës së Ambasadorëve për Shqipërinë, 9 nëntor 1921, dhe në përgjigje të kërkesës së qeverisë shqiptare për njohje, qeveria federale e Republikës së Austrisë më 18 shkurt 1922 njoftoi zyrtarisht qeverinë shqiptare se njihte Shqipërinë si shtet sovran dhe të pavarur dhe shprehte dëshirën për zhvillimin dhe konsolidimin e marrëdhënieve miqësore midis dy vendeve.¹ Që para arritjes së vendimit të Konferencës së Ambasadorëve për Shqipërinë, në prill 1921, në Vjenë u hap Zyra e Pasaportave që drejtohej nga Gjergj Pekmezi, një sekretar Nikollë (Kol) Rrota, dhe një daktilografiste.² Konsulli i parë i qeverisë shqiptare në Vjenë, Gjergj Pekmezi, i arsimuar në Austri, do të vazhdonte ta kryente këtë detyrë deri në tetor 1924, kur qeveria e Fan Nolit do të emëronte Nush Bushatin si konsull të Përgjithshëm të Shqipërisë në Vjenë.³ Nush Bushati, i doktoruar gjithashtu në Vjenë, kishte marrë pjesë aktive në Shoqërinë “Bashkimi” dhe Revolucionin e Qershorit 1924. Pekmezi qëndroi në Vjenë dhe nuk u kthye në Tiranë pas largimit të tij nga detyra e konsullit. Në tetor të vitit 1925, Bushati u zëvendësua nga Çatin Saraçi.⁴ Saraçi qëndroi në këtë detyrë deri në mesin e vitit 1930. Nga kjo kohë e

¹ *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme* (më tej: *AMPJ*), Viti (më tej: *V.*) 1922, Dosja (më tej: *D.*) 38, fl. 17, 50. Notë verbale e Ministrisë Federale të Punëve të Jashtme, 18 mars 1922, Korrespondencë e Konsullatës Shqiptare në Vjenë për MPJ, 11 mars 1922.

² *Po aty*, *V.* 1922, *D.* 143, fl. 14-15, Korrespondencë e konsullatës shqiptare në Vjenë me MPJ, 25 shkurt 1922.

³ Uran Asllani, *Diplomacia dhe Diplomatët shqiptarë (1912-1944)*, Tiranë: 2006, f.162.

⁴ *AMPJ*, *V.* 1922, *D.* 60, fl. 14, Lista e legatave dhe e konsullatave shqiptare; *po aty*, *V.* 1925, *D.* 66, fl.2, Korrespondencë e konsullatës shqiptare në Vjenë për MPJ, tetor 1925.

deri në shtator 1933, konsullata shqiptare në Vjenë u drejtua nga Kol Rrota si gjerent i saj. Më pas, nga tetori 1933 e deri në prill 1939, Kol Rrota shërbeu si konsull dhe kryeskonsull në Vjenë.

Ndërkohë Austria dhe interesat austriake u përfaqësuan nga konsulli i saj i Nderit në Shkodër, z. Stefan Zurani, nënshtetas shqiptar, në vitin 1923.⁵ Në vitin 1929 Ministria e Punëve të Jashtme të Austrisë autorizoi konsullin e saj të Nderit në Shkodër të kërkonte leje nga qeveria shqiptare për të hapur nënkonsullata në qytete të tjera të Shqipërisë.⁶

Me iniciativën e shkrimtarit të njohur Friedrich Wallisch dhe disa anëtarëve të kolonisë shqiptare në Vjenë u krijua Shoqëria e Miqësisë Austro-Shqiptare. Komiteti themelues me 15 anëtarë hartoi statutin e saj i cili u miratua më 30 prill 1929.⁷ President i saj u zgjodh shkrimtari Wallisch, dhe nënkryetarë skulptori i njohur Karl Gurschner dhe Gjergj Pekmezi. Ditën e themelimit shoqëria i dërgoi telegrame përshëndetjeje Presidentit të Republikës Federale të Austrisë, Guillaume Miklias, dhe Mbretit shqiptar, Zogu i I-rë.⁸ Qëllimet e kësaj Shoqërie ishin ekonomike dhe kulturore. Ajo u prit shumë mirë nga qarqet qeveritare e joqeveritare. Pritej që kjo shoqëri të kontribuonte në ngritjen në Vjenë të një Dhome austro-shqiptare të tregtisë, siç kishin edhe shtetet e tjera të kohës.⁹

Friedrich Wallisch u emërua edhe Kryekonsull i Nderit i Shqipërisë në Grac. Ai u arrestua në shtator 1934 nga policia në Vjenë për propagandë në favor të regjimit të partisë nacional-socialiste në Gjermani.¹⁰ Kjo parti ishte e ndaluar në Austri. Megjithëse doli nga burgu për mungesë faktesh, shteti austriak nuk e lejoi të ushtronte detyrën e tij. Në tetor të vitit 1934 ai u pushua nga qeveria shqiptare nga pozicioni i Kryekonsullit të Nderit.¹¹

Duke vlerësuar pozicionin e Shqipërisë nga pikëpamja ndërkombëtare dhe ekonomike, me qëllim që të forcoheshin marrëdhëniet dypalëshe qeveria austriake emëroi në dhjetor të vitit 1930 përfaqësuesin e saj të parë diplomatik në Shqipëri në rangun Ministër Fuqiplotë, Othon Gunther, i akredituar pranë Republikës Greke po në vitin 1930. Përfaqësuesi austriak mbërrin në Durrës

⁵ *Po aty*, V. 1923, D. 122, fl. 5, 8, Miratimi i Këshillit të Lartë të Shtetit për kandidaturën e Stefan Zuranit, 7 prill 1923, dhe Nota Verbale e Ministrisë Federale të Punëve të Jashtme, 15 mars 1923.

⁶ *Po aty*, V. 1929, D. 195, fl.12, Korrespondencë e Stefan Zuranit me MPJ, 25 maj 1929.

⁷ *Po aty*, V.1929, D. 294, fl.8, Korrespondencë e konsullatës tonë në Vjenë me MPJ.

⁸ *Po aty*, fl.13, Korrespondencë e konsullatës tonë në Vjenë me MPJ.

⁹ *Po aty*, fl.8, Korrespondencë e konsullatës tonë në Vjenë me MPJ.

¹⁰ *Po aty*, V.1934, D. 68, fl.1-3, Korrespondencë e konsullatës në Vjenë për MPJ, 28-29 shtator 1934.

¹¹ *Po aty*, fl.9, MPJ për konsullatën mbretërore në Vjenë, 22 tetor 1934.

nga mesi i janarit 1931 dhe paraqet para Mbretit shqiptar Zogu I-rë letrat e tij kredenciale si i dërguar i Jashtëzakonshëm dhe ministër Fuqiplotë i Austrisë në Shqipëri, me qëndrim në Athinë.¹² Ky zhvillim i ri diplomatik për marrëdhëniet shqiptaro-austriake lidhej edhe me zhvillimet pozitive në marrëdhëniet italo-austriake dhe mbështetjen italiane ndaj zhvillimeve të brendshme politike në Austri. Gutter ishte njëkohësisht i akredituar edhe në Kajro.¹³ Ndërkohë punët në Konsullatën Mbretërore të Shqipërisë në Vjenë i drejtonte gjerenti Kotta.

Në korrik të vitit 1931, Stef Zurani jep dorëheqje nga posti i Konsullit të Nderit të Austrisë në Shkodër. Ai njofton për këtë Ministrinë e Punëve të Jashtme të Shqipërisë. Deri në emërimin e një konsulli tjetër, interesat e Austrisë në Shqipëri nga pikëpamja konsullore do t'i ngarkoheshin konsullatës gjermane në Tiranë.¹⁴ Në shkurt 1932, pala austriake propozon Aleksandër Hobdarin si konsull Nderi të Austrisë në Tiranë¹⁵. Në gusht 1932, i Ngarkuari me Punë i Gjermanisë ia kalon tërë çështjet konsullore të Austrisë konsullit të ri të Nderit Aleksandër Hobdarit, drejtor i shoqërisë "Sita".¹⁶ Hobdari jep dorëheqje nga kjo detyrë në gusht të vitit 1935.¹⁷ Qëndroi në detyrë deri në shtator 1935 kur u zëvendësua nga Asim Abdurahmani.

Otto Gunther përfaqësoi Austrinë në Shqipëri deri në mesin e vitit 1933. Ai largohet për t'u emëruar në Paris.¹⁸ Në fund të vitit 1933, ai u pasua në këtë detyrë nga M. Lothaire Wimmer, ish këshilltar në legatën austriake në Londër.¹⁹ Wimmer mbuloi Greqinë, Shqipërinë dhe Egjiptin. Më 30 maj 1934 Wimmer paraqiti kredencialet në oborrin mbretëror.²⁰

Në vitin 1931 u nënshkrua marrëveshja e parë midis dy vendeve "Konventë për heqjen reciproke të sistemit të vizave midis Shqipërisë dhe Austrisë".²¹ Në shtator të vitit 1935 qeveria federale e Austrisë emëroi ing. Asim Abdurahmani, nënshkruar shqiptar, konsull Nderi me juridiksion në tërë

¹² *Po aty*, V. 1930, D. 110, fl. 1-3, 4 tetor 1930; *po aty*, fl. 23, Konsullata shqiptare në Vjenë për MPJ, 12 janar 1931.

¹³ *Po aty*, V. 1933, D. 144, fl.12, Konsullata e Përgjithshme në Vjenë për MPJ, 20 janar 1933.

¹⁴ *Po aty*, V. 1931, D. 62, fl.31, Letër e MPJ për MPB, 6 gusht 1931.

¹⁵ *Po aty*, V. 1932, D. 83, fl.9, MPJ për MPB, 2 gusht 1932.

¹⁶ *Po aty*, fl.12, MPJ për MPB, 23 gusht 1932.

¹⁷ *Po aty*, fl.19, MPJ për MPB, 5 shtator 1935.

¹⁸ *Po aty*, V.1933, D. 145, Informacion i MPJ, 10 qershor 1933; *po aty*, D.144, fl.15, Konsullata e Përgjithshme në Vjenë për MPJ.

¹⁹ *Po aty*, V.1933, D. 146, fl.3, Letra kredenciale për Lothaire Wimmer, i dërguar i Jashtëzakonshëm dhe ministër Fuqiplotë i Austrisë pranë Oborrit Mbretëror, 31 dhjetor 1933.

²⁰ *Po aty*, V.1933, D. 144, fl.40, MPJ për legatën shqiptare në Athinë, 18 maj 1934.

²¹ *Po aty*, Fondi i marrëveshjeve, V.1931, L.5.

Shqipërinë.²² Ing. Abdurrahmani duke qenë përfaqësues i fabrikave gjermane dhe simpatizant i nacionalsocialistëve, nuk gëzoi asnjëherë besimin e plotë të qeverisë austriake.²³

Ndërkohë më 15 nëntor 1935, Agjencia Telegrafike shqiptare njoftonte që ministri i Punëve të Jashtme të Austrisë, z. Baron Berger-Waldenegg, në fjalimin që mbajti para komitetit-buxhetor kishte kërkuar krijimin e një përfaqësie diplomatike në Shqipëri.²⁴ Konsullata Mbretërore e Shqipërisë njoftonte se gjatë bisedimeve parlamentare mbi buxhetin financiar të Austrisë për vitin 1936, MPJ Baron Berger-Waldenegg ndër të tjera kishte bërë këtë deklaratë “Një nevojë e domosdoshme asht ndreqja e një përfaqësjie efektive në Shqipëri. Në Shqipni kemi një koloni të madhe austriakësh, dhe me të vërtetë kjo ndodhet në rrezik të humbë. Konsulli i Nderit ishte një shtetas i huaj, prandaj kane ngja disa vështirësira. Asht e nevojshme pra që të dërgohet në këtë pjesë të Ballkanit një njeri për të organizuar dhe mbrojtur koloninë tonë”.

Ministri Berger-Waldenegg e njihte mirë Shqipërinë që kur kishte shërbyer si sekretar i legatës austro-hungareze në Durrës, ushqente një simpati të vërtetë për kombin shqiptar dhe synonte të rigjallëronte traditën e miqësisë së vjetër midis Austrisë dhe Shqipërisë.

Në analizën që bëu konsulli i Përgjithshëm në Vjenë gjen dy arsye që e shtrëngonin Austrinë të dërgonte sa më parë përfaqësues diplomatik në Shqipëri: 1-Propoganda nacionalsocialiste e legatës gjermane në Tiranë brenda kolonisë austriake në Shqipëri, prej ku kishin dalë edhe ankesat, 2-Interesat ekonomike të Austrisë në Shqipëri. Sipas statistikave tregtare Austria po e humbte krejt tregun shqiptar, në qoftë se nuk tregohej më aktive në këtë drejtim. Planifikohej edhe lidhja sa më shpejt e një traktati tregtar me Shqipërinë.²⁵ Komisioni financiar i parlamentit i miratoi Ministrisë së Punëve të Jashtme buxhetin për emërimin në fillim të vitit 1936 të një Kryekonsulli efektiv si përfaqësues diplomatik në Shqipëri në vend të pozicionit të Konsullit të Nderit.²⁶

Propozimin e ministrit Berger-Waldenberg e mbështeti edhe kryeredaktori i gazetës “Reichspost”, organ zyrtar i qeverisë austriake, Funder. Ai shtoi “Austria duhet të mbrojë në Shqipëri një kapital të madh të prestigjit moral, qi

²² *Po aty*, V. 1935, D. 97, fl.4, Notë Verbale e legatës austriake në Athinë për MPJ, 19 gusht 1935.

²³ *Po aty*, fl.8, Konsullata e Përgjithshme në Vjenë për MPJ, 13 nëntor 1935.

²⁴ *Po aty*, fl.7, Njoftim i Agjencisë Telegrafike Shqiptare, 15 shtator 1935.

²⁵ *Po aty*, fl.8, Konsullata e Përgjithshme në Vjenë për MPJ, 13 nëntor 1935.

²⁶ *Po aty*, fl.10, Konsullata e Përgjithshme në Vjenë për MPJ, 25 nëntor 1935.

themelohet në tradicione të vjetra dhe së fundi në kujtim mirënjohjeje të veprës kulturore që ushtritë tona kanë kryer në Shqipni në kohë të okupacionit”.²⁷

Por në fund të dhjetorit 1935, interesimit të Konsullit të Përgjithshëm në Vjenë qeveria austriake iu përgjigj se për arsye financiare propozimi i MPJ për hapjen e një përfaqësie diplomatike në Tiranë nuk arriti të finalizohet me sukses për vitin 1936.²⁸

Këtë propozim e risolli në vëmendjen e politikës dhe parlamentit austriak përsëri Funder në fund të vitit 1936 për buxhetin e vitit 1937. Tani Austria kishte më shumë shanse për një politikë të jashtme të pavarur, sepse që nga viti 1936 ajo nuk ishte më nën kontrollin e Lidhjes së Kombeve. Ai rithekson nevojën e arritjes së një marrëveshjeje tregtare me Shqipërinë pasi para luftës Austria ishte vendi i parë eksportues në Shqipëri, ndërsa në vitet '30-të kishte vajtur në vendin e tetë. "Përmirësimi i pozitës tonë tregtare e politike në Shqipëri parashef një përfaqësim më të fortë interesash. Austria ka sot në Shqipëri vetëm një Konsull Nderi, prandaj është e domosdoshme ngritja e një Agjensie Diplommatike në Tiranë”.²⁹

Duke ndjekur reciprocikisht dëshirën e palës austriake për të përforuar prezencën e saj diplomatike në Shqipëri, Ministria e Jashtme shqiptare në maj të vitit 1936 shton buxhetin e Konsullatës Mbretërore në Vjenë me plus 50 franga në muaj me qëllim që edhe kjo Konsullatë mund të ngarkohet me çështje diplomatike duke u varur nga legata shqiptare në Berlin. Për këtë funksion të ri konsullata duhej të vendosej në një ambient më të gjerë në Vjenë. Pjesë e saj do të ishte një zyrë e përfaqësuesit të Berlinit kur ai të vinte me mision në Vjenë. Nga ana tjetër titullari i konsullatës mund të ngarkohet që të zëvendësonte në Vjenë titullarin e legatës në Berlin. Me fjalë të tjera, kërkohet që kjo konsullatë të kthehet në Agjenci Diplommatike.³⁰

Në rrethanat e rritjes së prezencës nacionaliste në Austri në nëntor të vitit 1937, z. Egon Berger-Waldenegg paraqet kredencialet e tij tek Mbreti Zogu I-rë si i dërguar i Jashtëzakonshëm dhe ministër Fuqiptotë i Austrisë në Shqipëri tashmë me qëndrim në Romë.³¹

²⁷ *Po aty*, V.1935, D. 98, fl.1, Konsullata e Përgjithshme në Vjenë për MPJ, 7 dhjetor 1935.

²⁸ *Po aty*, V.1935, D. 97, fl.11, Konsullata e Përgjithshme në Vjenë për MPJ, 31 dhjetor 1935.

²⁹ *Po aty*, V. 1936, D. 89, fl.5-6, Konsullata e Përgjithshme në Vjenë për MPJ, 18 nëntor 1936.

³⁰ *Po aty*, fl.1-2, MPJ për Konsullatën e Përgjithshme në Vjenë dhe anasjelltas, 21 maj 1936 dhe 16 qershor 1936.

³¹ *Po aty*, V. 1937, D. 93, fl.9, Letrat kredenciale të Presidentit austriak për Egon Berger Waldenegg, 10 nëntor 1937.

Më 8 shkurt 1938 legata e Austrisë në Romë, e akredituar edhe në Tiranë, lajmëron Ministrinë e Punëve të Jashtme se Ministria e Mbrojtjes Kombëtare e Austrisë dëshironte ta akreditonte atasheun ushtarak dhe aeronautik pranë legatës në Romë, kolonel të Shtabit Madhor, Erhard Raus, edhe pranë qeverisë Mbretërore Shqiptare. Kërkesa u miratua nga Mbreti Zogu I-rë.³²

Deri në fillim të Luftës së Dytë Botërore, Austria nuk hapi një përfaqësi diplomatike apo konsullore në Shqipëri, por u përfaqësua me konsujt e nderit, nënshtetas shqiptarë që mbronin kryesisht interesat ekonomikë të Austrisë në Shqipëri, por që nuk kishin mandatin e konsullit si anëtar i shërbimit të jashtëm austriak. Ndërkohë Shqipëria vazhdoi të përfaqësohet në Vjenë me Konsullatën e saj të Përgjithshme deri në vitin 1939. Për shkak të zhvillimeve të reja politike e ushtarake që solli Lufta e Dytë Botërore për të dy vendet, marrëdhëniet midis tyre u ndërpreu.

Rivendosja e marrëdhënieve diplomatike

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, qeveria e re komuniste filloi përpjekjet për njohjen e saj ndërkombëtare. Sa më shumë thelloheshin zhvillimet e Luftës së Ftohtë dhe grupimi i shteteve në blloqet politiko-ushtarake të kësaj lufte, aq më tepër kufizohej harta gjeografike e njohjeve të qeverisë komuniste. Për shkak të pozicionit të saj neutral, në zbatim të pikave të Traktatit të Paqes me Austrinë, kjo e fundit ishte një ndër vendet e pakta perëndimore që Tirana zyrtare në rrugë diplomatike, jo publike, bëri përpjekje të ngjallte interesin e qeverisë austriake për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike.³³

Pas nënshkrimit të Traktatit të Paqes së katër Fuqive të Mëdha me Austrinë, 15 maj 1955, ngacmuar nga sinjalet që vinin nga Tirana zyrtare, synimet e vjetra politike austriake për ekuilibër në rajon, dhe interesat tregtare austriake në Shqipëri, qoftë edhe si vend transit, në korrik të vitit 1955 pala austriake shfaqti nëpërmjet përfaqësuesit të saj diplomatik në Sofje, interesin e saj për rivendosje të marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë, si i vetmi vend i Demokracive Popullore me të cilin nuk kishin marrëdhënie diplomatike.³⁴ Qeveria austriake vendosi zyrtarisht për këtë hap në marrëdhëniet e saj me Shqipërinë në mbledhjen e 20 dhjetorit të vitit 1955. Si vend neutral, Austria mori garanci për këtë hap pasi Shqipëria u bë anëtare me të drejta të plota në OKB, 14 dhjetor 1955. Në një kuadër më të gjerë gjeopolitik, politika amerikane nxiste vendet perëndimore që të kishin prezencë diplomatike në

³² *Po aty*, V. 1938, D. 78, fl.11-12, Korrespondencë e MPJ me Oborrrin Mbretëror, shkurt 1938.

³³ *Po aty*, V. 1956, D. 183, fl.7, Korrespondencë e legatës shqiptare në Beograd me MPJ, 10 janar 1956.

³⁴ *Po aty*, fl.1, Informacion i përfaqësuesit në Sofje për Tiranën, 16 korrik 1955.

Shqipëri, duke mos anashkaluar asnjë propozim të qeverisë shqiptare për këtë hap, me qëllim që Shqipëria komuniste, me një pozicion shumë të rëndësishëm gjeostrategjik, të mos zhytej totalisht në Kampin Lindor dhe influencën e Moskës.

Më 9 janar 1956, ambasadori austriak në Beograd, Walter Wodak, i bëri një vizitë ministrit Fuqiplotë të Republikës Popullore të Shqipërisë në Beograd, Bato Karafili. Wodak komunikoi vendimin e qeverisë austriake për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike .Pala austriake kërkoi të dinte nëse qeveria shqiptare ishte dakord për këtë.³⁵ Ajo propozoi edhe mënyrën e vendosjes së këtyre marrëdhënieve, me shkëmbim notash midis dy përfaqësive diplomatike në Beograd dhe pastaj një komunikatë e përbashkët në shtyp. Zgjedhja e Beogradit si qendër për kryerjen e këtij akti gjeopolitikisht ishte jo pa qëllim nga ana e Austrisë. Që nga viti 1948 Jugosllavia kishte dalë formalisht nga Blloku Lindor dhe qëndronte jashtë blloqeve të Luftës së Ftohtë. Qëndrimi i qeverisë shqiptare ishte i menjëhershëm në dakordësi me vendimet e qeverisë austriake, por duke e quajtur këtë moment si “vendosje” dhe jo “rivendosje” të marrëdhënieve diplomatike me Austrinë. Më 7 shkurt 1956 në selinë e legatës shqiptare në Beograd, midis të dërguarit të Jashtëzakonshëm dhe ministër Fuqiplotë të Republikës Popullore të Shqipërisë dhe ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Republikës Austriake në Beograd, me autorizim të qeverive respektive, u këmbyen nota diplomatike në bazë të të cilave midis dy vendeve u vendosën marrëdhënie normale diplomatike dhe konsullore.³⁶ Që nga 13 qershori 1956 Austria u përfaqësua në Shqipëri nga Walter Wodak, si i dërguar i Jashtëzakonshëm dhe ministër Fuqiplotë i Austrisë në Shqipëri me qëndrim në Beograd. Ai u pasua në këtë detyrë nga Vilhelm Goertz, në shtator të vitit 1960. Ndërkohë që nga 10 tetori 1956, Shqipëria u përfaqësua diplomatikisht në Austri nga Koço Prifti si i dërguar i Jashtëzakonshëm dhe ministër Fuqiplotë i Shqipërisë në Austri me qëndrim në Pragë.³⁷ Ai u pasua në këtë detyrë nga Siri Çarçani në prill të vitit 1960.

Më 27 korrik 1961, u nënshkrua në Vjenë, marrëveshja e parë midis dy qeverive, pas rivendosjes së marrëdhënieve diplomatike, “Mbi shkëmbimin e mallrave dhe pagesat midis qeverisë së RP të Shqipërisë dhe Qeverisë federale Austriake”.³⁸ Marrëveshja lidhej drejtpërsëdrejti me interesat ekonomike të të dy vendeve.

³⁵ *Po aty*, V. 1956, D. 183, fl.10, Informacion i përfaqësisë në Beograd për Tiranën, 14 janar 1956.

³⁶ *Po aty*, V. 1956, D.183, fl. 22-26, Notë diplomatike midis dy ambasadave respektive në Beograd, 7 shkurt 1956.

³⁷ *Po aty*, V. 1956, D. 441, fl.7-9,16-17, Kredencialet për emërim ambasadorësh respektivë.

³⁸ *Po aty*, Fondi i marrëveshjeve, V. 1961, L. 4.

Në kushtet e ashpërsimit të marrëdhënieve me Moskën, më 12 dhjetor 1961, e interesuar të forcojë marrëdhëniet e saj politike me Vjenën zyrtare, duke e konsideruar Austrinë qendër strategjike diplomatike ku përballeshin Lindja dhe Perëndimi politik dhe ku kontaktet me faktorin ndërkombëtar ishin më të mundshme, qeveria shqiptare njoftoi Ministrinë e Punëve të Jashtme të Republikës së Austrisë se ajo kishte vendosur të hapte një mision të përhershëm diplomatik në Vjenë në rang legatë. Deri në mbërritjen e titullarit të saj, ajo u drejtua nga Mehmet Çaka, si i ngarkuar me Punë.³⁹ Më 9 mars 1962 paraqiti kredencialet si i dërguari i Jashtëzakonshëm dhe ministri Fuqiplotë i parë me qëndrim në Vjenë, Gaqo Nesho.⁴⁰ Ndërsa qeveria austriake vazhdoi të përdorte argumentin e vështirësive financiare për hapjen e një përfaqësie diplomatike në Tiranë. Ky argument u përdor deri në vitin 1992 me ndryshimet demokratike në Shqipëri.⁴¹ Nga prilli i vitit 1964 Vjena zyrtare u përfaqësua në Tiranë nga Karl Harti, i dërguar i Jashtëzakonshëm dhe ministër Fuqiplotë me qëndrim në Beograd.

Në dhjetor 1965 pala shqiptare shpreh interesin e saj për ngritjen e nivelit të përfaqësimit diplomatik nga legatë në ambasadë respektivisht në të dy vendet. Kjo kërkesë u artikulua nga ministri Fuqiplotë dhe i Jashtëzakonshëm i RP të Shqipërisë në Vjenë, Gaqo Nesho, në takim me ministrin e Punëve të Jashtme të Austrisë, Krajski. Ky i fundit kërkoi që kjo kërkesë të formulohej zyrtarisht në notë diplomatike.⁴² Kjo notë nuk u përgatit nga pala shqiptare, por në vend të saj u përgatit një Promemorie për Ministrinë e Punëve të Jashtme të Austrisë. Në të propozohej që më 15 mars 1966 të dy palët të dilnin me një komunikatë të përbashkët nga dy qeveritë mbi dakordësinë e tyre për ngritjen e nivelit të legatave në nivel ambasadash.⁴³ Propozimi i palës shqiptare u diskutua në takimet e punës së qeverisë austriake. Nga informacioni që legata shqiptare kishte arritur të siguronte, ky propozim u mbështet nga ministri i Jashtëm Dr. Bruno Kreisky dhe Sekretari i Shtetit Dr. Carl Bobleter me argumentin se ngritja e legatave me Shqipërinë në nivel ambasadash do të ndikonte për mirë në marrëdhëniet me Kinën. Me këtë të fundit, Austria nuk mund të vendoste marrëdhënie pasi sipas Kraksit “zemëroheshin miqtë amerikanë”. Nuk është lënë pa përmendur fakti që Shqipëria shërbente si

³⁹ *Po aty*, V. 1962, D. 264, fl.1, Notë e MPJ të RP të Shqipërisë për MPJ e Republikës Federale të Austrisë.

⁴⁰ *Po aty*, V. 1962, D. 811, fl.3, 12, Kredencialet e ambasadorit Gaqo Nesho.

⁴¹ *Po aty*, V. 1962, D. 264, fl.5, Informacion i legatës shqiptare në Bukuresht për Tiranën, 24 korrik 1962.

⁴² *Po aty*, V. 1966, D.138, fl.1, Komunikim i legatës shqiptare në Vjenë me MPJ, 10 janar 1966.

⁴³ *Po aty*, fl.3, Komunikim i MPJ me legatën tonë në Vjenë, 14 janar 1966.

balancim i faktorit sllav në Ballkan.⁴⁴ Pasi propozimi i qeverisë shqiptare mori përgjigje pozitive nga MPJ e Austrisë, qeveria shqiptare aprovoi më 3 mars 1966 ngritjen e përfaqësive diplomatike të RP të Shqipërisë në Vjenë dhe të Republikës Austriake në Tiranë në rang ambasdash dhe midis të dy vendeve të shkëmbeheshin ambasadorë.⁴⁵ Siç ishte rënë dakord, Komunikata e Përbashkët u bë publike më 15 mars 1966. Karl Hart paraqiti përsëri letrat e tij kredenciale para Presidiumit të Kuvendit Popullor të RPSH në maj 1966, tashmë si ambasador i Austrisë me qëndrim në Beograd. Ai u pasua në këtë detyrë nga Z. Walter Peinsip në dhjetor të vitit 1968. Ndërsa ambasadori i parë shqiptar në Vjenë do të ishte Murat Angoni, i cili paraqiti letrat e tij kredenciale në dhjetor të vitit 1966. Ai u pasua në këtë detyrë nga Dhimitër Tona në shkurt 1969.⁴⁶

Po në vitin 1966, nën kujdesin e Komitetit të Marrëdhënieve Kulturore me Botën e Jashtme, u ngrit Shoqata e Miqësisë Shqipëri-Austri, e cila mbahej vazhdimisht afër nga ambasada shqiptare në Vjenë.⁴⁷

Duke e marrë me rezervë gjithmonë miqësinë e ofruar nga pala austriake, pasi konsiderohej si e shtyrë nga qeveria amerikane dhe shtetet anëtare të NATO-s për të luajtur rolin e urës së afrimit me vendet e Lindjes duke shfrytëzuar statusin e saj si “shtet neutral” përcaktuar në Traktatin e Paqes, maj 1955⁴⁸, qeveria shqiptare nuk e nxiste shumë hapjen e ambasadës austriake në Tiranë. Edhe qeveria austriake nuk duket shumë e interesuar për këtë hap dhe vazhdimisht e justifikon mungesën e prezencës së saj diplomatike në Tiranë me arsye financiare.

Më 14 qershor 1967 ambasada austriake në Beograd njofton Ministrinë e Punëve të Jashtme të RPSH, se në mungesë të ambasadës shqiptare në Tiranë, Dhoma Federale e Tregtisë në Vjenë kishte ngarkuar Karl Albert Deuring, drejtor në këtë institucion, që të menaxhonte marrëdhëniet tregtare me Shqipërinë. Ai do të realizonte këtë me anë të vizitave periodike në Shqipëri për të vendosur kontaktet e nevojshme me autoritetet shqiptare.⁴⁹ Megjithëse për qeverinë shqiptare kjo praktikë tingëllonte e çuditshme, e pranoi të mirëqenë vendimin e palës austriake.

Nga nëntori 1972 Austria u përfaqësua në Tiranën zyrtare nga Aleksandër Karl Otto, me qëndrim në Beograd deri në janar të vitit 1978, kur këtë detyrë e

⁴⁴ *Po aty*, V. 1966, D.138, fl.18, Komunikim i përfaqësive shqiptare në Vjenë për MPJ.

⁴⁵ *Po aty*, fl. 16, VKM nr.1, dt. 3 mars 1966.

⁴⁶ *Po aty*, V. 1969, D.490, fl.24, Kredencialet e ambasador Dhimitër Tona, shkurt 1969.

⁴⁷ *Po aty*, V. 1966, D.140, fl.28, Relacion i ambasadës shqiptare në Vjenë për vitin 1966, shkurt 1967.

⁴⁸ *Po aty*, fl.24, Relacion i ambasadës shqiptare në Vjenë për vitin 1966, shkurt 1967.

⁴⁹ *Po aty*, V.1967, D.145, fl.12-13. Nota diplomatike e MPJ austriake, 14.06.1967 dhe nota e MPJ shqiptare, 22 qershor 1967

ushtroi Helmut Liedermann. Ndërkohë në shtator 1973 në Vjenë paraqiti letrat e tij kredenciale si ambasador i Shqipërisë Sokrat Plaka, i cili në shtator 1976 u pasua në detyrë nga Zihni Haskaj dhe në prill 1979 nga Musin Kroj.

Pas vdekjes së Hoxhës dhe fillimit të tendencave liberalizuese në politikën e jashtme shqiptare, në kushtet e rëndësës së vazhdueshme të situatës ekonomike në vend për shkak të vetizolimit, si dhe në kuadër edhe të frymës së re pozitive në marrëdhëniet Lindje-Perëndim, marrëdhëniet diplomatike Shqipëri-Austri njohin zhvillime të reja politike. Gjatë zhvillimit të punimeve Asamblesë së Përgjithshme të OKB në New York, 26 shtator 1985, ministri i Punëve të Jashtme të RPSH, Reis Malile, takoi homologun austriak Leopold Grac në selinë e Misionit austriak pranë OKB dhe i propozoi për herë të parë MPJ të Austrisë që të dërgohej një delegacion i MPJ të Austrisë i kryesuar nga një zëvendësministër për të bërë një vizitë miqësore në Shqipëri dhe për të shkëmbyer konkretisht mendime lidhur me zhvillimin e marrëdhënieve në fusha të ndryshme, në radhë të parë ato në fushën tregtare.⁵⁰ Propozimi u prit shumë mirë nga pala austriake dhe me entuziazëm të madh si një ndryshim i dukshëm në marrëdhëniet dypalëshe. Grac theksoi se edhe në Evropë kishte zhvillime të reja për mirë. Futja e dy superfuqive në bisedime njëri me tjetrin tregonte se po humbiste ajo gjendja e dikurshme e politikave të strukturave të ngurta e të ashpra. Ndaj edhe dy palët kishin nevojë të bisedonin sinqerisht për këto zhvillime në pozita miqësore.⁵¹

Ambasada shqiptare në Vjenë ishte një qendër e fuqishme kontaktesh për diplomacinë shqiptare, e shtuar dukshëm kjo pas vitit 1985 në proceset e fillimit të hapjes së Shqipërisë me Perëndimin. Në këtë periudhë ambasada shqiptare në Vjenë drejtohej nga Idriz Bardhi (1983-1988) e më pas nga Engjëll Kolonci (1988-1992). Ndërsa pala austriake në vitet '80-të u përfaqësua në Shqipëri nga ambasadorët e saj në Beograd, konkretisht Dr. Norbert Linhart (1982-1986) dhe Paul Leifer (1986-1990).

Në takimin që ambasadori austriak Paul Leifer bëri me Kryetarin e Presidiumit të Kuvendit Popullor, Ramiz Alia, më 4 mars 1986, ai u shpreh për dëshirën austriake që midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë të kishte marrëdhënie të fqinjësisë të mirë. Ndër të tjera ai do të argumentonte diplomatikisht: "Me gjithë sistemet e ndryshme, kemi pozicion gjeografik të ngjashëm, dhe besoj se kjo është bazë e rëndësishme për të bashkëpunuar në ato fusha të interesit reciprok. Ne nuk mund të përfytyrojmë asgjë më të bukur se bashkëpunimi ndërmjet Zvicrës, Austrisë, Jugosllavisë, dhe Shqipërisë. Për këtë arsye ka interes të madh për marrëdhënie të mira midis jush dhe Jugosllavisë".⁵² Vihet re

⁵⁰ *Po aty*, V.1985, D.140, fl.10, Informacion i Misionit të RSH në OKB.

⁵¹ *Po aty*, fl.11-12, Informacion i Misionit të RSH në OKB.

⁵² *Po aty*, V. 1986, D.139, fl.27, Protokoll i bisedës së Kryetarit të Presidiumit të Kuvendit Popullor, R.Alia me ambasadorin austriak, Leifer, 4 mars 1986.

dëshira austriake për të forcuar kordonin amortizator midis dy blloqeve, nën ndikimin e faktorit perëndimor, si garanci për ruajtjen e ekuilibrave gjeopolitike. Çdo përfshirje e plotë e këtij kordoni në përbërje të ndonjërit nga blloqet do të vinte në pikëpyetje ecurinë e përpjekjeve për zbutjen e konfliktit Lindje-Perëndim. Në këtë kontekst Shqipëria e vogël dhe e vetizoluar përbënte një pikë të rëndësishme referimi për qendrat e mëdha të politikës botërore, të cilën ajo mund ta shfrytëzonte në dobi të interesave të saj të drejtpërdrejta.

Në reciprocitet të marrëdhënieve, më 16 nëntor 1987 sekretari i Shtetit për Punët e Jashtme në MPJ e Austrisë Thomas Kleft, i dërgoi një ftesë zyrtare zv/ministrit të Punëve të Jashtme, Sokrat Plaka, për të vizituar Austrinë. Ftesa dorëzohet në Tiranë nga numri dy i ambasadës austriake në Beograd Yuri Standenat, më 1 dhjetor 1987. Duke vënë theksin tek rëndësia e dy vendeve në korridorin gjeostrategjik, ndër të tjera në ftesë thuhej “Shqipëria dhe Austria shohin nga e kaluara një rrugë të gjatë të zhvillimeve historike që luajtën një rol të rëndësishëm në formësimin e Evropës siç e njohim sot. Për më tepër, unë e ndjej që ekzistojnë mundësi të mëdha për të rritur dhe zhvilluar kontaktet reciproke në interes të përbashkët të të dy vendeve tona. Është kjo arsyeja që unë do të gjykoja për një dialog të rilindur ndërmjet dy vendeve tona për të përfutur jo vetëm tek marrëdhëniet dypalëshe, por gjithashtu për të kontribuar për një kuptim më të mirë në një kontekst më të gjerë evropian”.⁵³ Ministria e Punëve të Jashtme ia dërgoi ftesën Komitetit Qendror të PPSH dhe atje u ra dakord politikisht që ajo të pranohet. U dha udhëzim që diskutimi i problemeve politike gjatë vizitës do të ishte i përgjithshëm e pa angazhime konkrete. Pala shqiptare do të ndalej kryesisht tek marrëdhëniet me Jugosllavinë dhe zhvillimet në Kosovë. Theksi do të vihej në bisedë tek problemet ekonomike, nevoja e rritjes së volumit të tregtisë ndërmjet dy vendeve dhe gjetja e formave të reja të bashkëpunimit ekonomik ndërmjet dy vendeve. Palës austriake do t’i sugjerohej gjithashtu hapja e Ambasadës në Tiranë dhe të ftohej për vizitë në Tiranë vitin tjetër ministri i Punëve të Jashtme të Austrisë, Alois Mok.⁵⁴

Vizita e zv/ministrit Sokrat Plaka në Vjenë u zhvillua më 7-9 nëntor 1988. Ajo ishte vizita e parë politike e një delegacioni shqiptar në Austri. Plaka u prit nga autoritetet më të larta të shtetit austriak. Ajo ishte një vizitë mjaft miqësore dhe me vullnet të mirë për të forcuar bashkëpunimin politik e ekonomik ndërmjet dy vendeve. Në respekt të pozitës ndërkombëtare të Shqipërisë, jashtë blloqeve, e gatshme për bashkëpunim me shtetet që ofrojnë dorën e bashkëpunimit pa ndërhyrë në çështjet e brendshme të shtetit, autoritetet austriake vinin theksin tek karakteristikat e ngjashme të politikës së jashtme austriake: neutraliteti, marrëdhëniet me vendet e Evropës Perëndimore dhe me

⁵³ *Po aty*, V.1987, D.140, fl.1, 2, Ftesa e Sekretarit të Shtetit austriak për Sokrat Plakën, 16 nëntor 1987.

⁵⁴ *Po aty*, fl.26-27, Shënime të MPJ për udhëheqjen.

ato të Evropës Lindore. Për mundësinë e hapjes së ambasadës austriake në Tiranë, pala austriake u shpreh se “ nga ana politike ishin dakord dhe është një gjë e dëshirueshme, por duhet të shikohen disa probleme me Ministrinë Federale për Financat dhe në Parlament”.⁵⁵ Gjatë vizitës delegacioni shqiptar i dorëzoi Ministrinë të Jashtëm austriak Alois Mok ftesën zyrtare të homologut të tij shqiptar, Reis Malile, për të vizituar Tiranën në vitin 1989.⁵⁶

Pas takimit të parë të ministrave të Punëve të Jashtme të Ballkanit në Beograd në shkurt të vitit 1988, më 31 tetor 1988, dhe në vijim të bisedës midis dy ministrave të Punëve të Jashtme në New York më 1 dhjetor 1988, zv/kancelari dhe ministri Federal i Punëve të Jashtme Alois Mock ftoi për vizitë zyrtare në Vjenë, e para e këtij lloji, ministrin e Punëve të Jashtme të Shqipërisë Reis Malile.⁵⁷ Shtypi gjerman këtë afrim të Shqipërisë me Austrinë e komenton “Austria preferohet nga Shqipëria pasi ka dhënë prova për rolin e saj si një shtet i pavarur dhe neutral”. Sipas vëzhguesve mediatikë, kjo vizitë zyrtare, e para e një zëvendësministri të jashtëm në Austri, konsiderohet si shenjë e hapjes ekonomike dhe politike të Shqipërisë”.

Në përgjigje të ftesës së palës shqiptare më 22-23 maj 1989 Tiranën zyrtare e vizitoi një delegacion politik i Austrisë i kryesuar jo nga ministri i Jashtëm Mok, por nga Sekretari i Përgjithshëm i MPJ, Dr. Thomas Klestil. Gjatë kësaj vizite u ra dakord që të shkëmbeheshin vizitat e Ministrave të Jashtëm gjatë 3-mujorit të parë të vitit 1990. U ra dakord gjithashtu të përfundohej një marrëveshje për heqjen e vizave për pasaportat diplomatike dhe të shërbimit me anë të këmbimit të notave.⁵⁸ Për shkak të zhvillimeve dinamike politike në Evropën Lindore këto vizita nuk u zhvilluan.

Me VKM nr.58, dt. 26.01.1991, pas lejitimit të pluralizmit politik në Shqipëri (dhjetor 1990), qeveria shqiptare vendosi të autorizojë çeljen në Tiranë të një zyre tregtare të Institutit Austriak për Tregtinë e Jashtme, Evidenzbuero, e cila do të shërbente për intensifikimin e kontakteve ekonomiko-tregtare ndërmjet ndërmarrjeve shqiptare që zhvillonin tregti me jashtë dhe firmave e institucioneve ekonomiko-tregtare austriake, anëtare të Evindenzbuero-s.⁵⁹

Më 9 gusht 1991, Ministria Federale e Punëve të Jashtme të Austrisë, nëpërmjet një note dërguar ambasadës shqiptare në Vjenë, i kërkon qeverisë shqiptare agreementin për Kurt Spallinger si ambasador i Republikës së Austrisë në Shqipëri, tashmë për herë të parë me qëndrim në Vjenë dhe që do të

⁵⁵ *Po aty*, fl.170-176, Informacion mbi takimet e S. Plakës në Vjenë, 7-9 nëntor 1988.

⁵⁶ *Po aty*, V.1988, D. 136, fl. 2-3, Ftesa e Reis Malile për A. Mok, 3 nëntor 1988.

⁵⁷ *Po aty*, V.1988, D. 139, fl. 4-5, Ftesa e ministrit të Punëve të Jashtme të Austrisë, A.Mok, për ministrin e Punëve të Jashtme, R. Malile, 31 tetor 1988.

⁵⁸ *Po aty*, V. 1989, D. 125, Informacion për vizitën e Th. Klestil në Tiranë, 30 maj 1989.

⁵⁹ *Po aty*, V. 1991, D. 96, fl.2, VKM. nr.58, dt. 26 janar 1991.

akreditohej vetëm në Shqipëri⁶⁰, duke demonstruar kështu një rritje të dukshme të vëmendjes së Vjenës zyrtare ndaj një Shqipërie që po hynte në rrugën e ndryshimeve të mëdha politike.

Në përgjigje të kësaj vëmendjeje dhe në përputhje me zhvillimet politike në Shqipëri, më 12-13 dhjetor 1991, ministri i Punëve të Jashtme të Shqipërisë Muhamet Kapllani viziton Austrinë, duke shënuar vizitën e parë të shefit të diplomacisë shqiptare në Vjenë. Gjatë vizitës palës austriake iu kërkua përsëri rikonsiderimi i mundësisë së hapjes së ambasadës në Tiranë, aq më shumë që me ngjarjet në Jugosllavi, përfaqësimi nga Beogradi nuk ishte i përshtatshëm për të dy vendet.⁶¹ Me krijimin e qeverisë së re demokratike në Tiranë, mars 1992, Spallinger në maj të këtij viti filloi përpjekjet për hapjen e një Zyre Përfaqësuese të ambasadës austriake në Tiranë, të cilën e realizoi gjatë vitit 1993.⁶² Ndërkohë në vitin 1992, Shqipëria u përfaqësua në Vjenë nga Albert Aliçka si ambasador i Republikës së Shqipërisë. Tashmë dy palët u përfaqësohen diplomatikisht në dy kryeqytetet respektive duke hapur një etapë më të vullshme bashkëpunimi midis dy vendeve në të gjitha fushat.

⁶⁰ *Po aty*, V. 1991, D.104, fl.5, Korrespondencë e ambasadës shqiptare në Vjenë me MPJ.

⁶¹ *Po aty*, V.1991, D. 98, fl.80-85, 94-96, Informacion për vizitën e ministrit të Punëve të Jashtme, Kapllani në Austri, 12-13.12.1991 dhe takimet në OKB.

⁶² *Po aty*, V.1992, D.57, fl.2, Informacion i Drejtorisë II në MPJ, 12 maj 1992.

